Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 922/20
Datë/Datum. 30.11.2020
PRISHTINE - PRIŠTINA

DATË/A:	**30 NËNTOR 2020**
REFERENCË:	**922/20**
PËR/ZA/TO:	**AK- "Kuvendi Komunal Prizren"**
NGA/OD/FROM:	**Blerim Dina Kryetar i – OSHP-së**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori ekonomik - **NTP "Thesar & NTP Bamirs" -Suharekë**, si palë e pakënaqur me datën: 12.11.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 922/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullimi i varrezave ne fshatin Krushë e Vogël", me nr. të prokurimit: 622-20-5064-5-2-1**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- **1, 6, 7, 59 dhe 69** të LPP-së

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 13 Nëntor 2020 kanë autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti shqyrtues i prokurimit me datën 23 Nëntor 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues **te aprovohet si e bazuar**, te anulohet propozimi për anulim te aktiviteti te prokurimit dhe lënda te kthehet ne **Ri -Vlerësim.**

Autoriteti kontraktues- **"Kuvendi Komunal Prizren"** me datën 23 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të njëjtit me datën 27 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës dhe presim qe lënda sa me pare te jete e mundur te na kthehet ne **Ri-vlerësim**.

Operatori ekonomik ankues **NTP "Thesar & NTP Bamirs" -Suharekë** me datën 23 Nëntor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues dhe të njëjtit me datën 23 Nëntor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **"Kuvendi Komunal Prizren"** për aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i varrezave ne fshatin Krushë e Vogël", me nr. të prokurimit: 622-20-5064-5-2-1, **te aprovohet si e bazuar**, te anulohet propozimi për anulim te aktiviteti te prokurimit dhe lënda te kthehet ne **Ri -Vlerësim**, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik **NTP "Thesar & NTP Bamirs" -Suharekë** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.